
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: NNP CTA SHPK me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	19.05.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **18.05.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **NNP CTA SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë në hapësira të jashtme dhe të brendshme në institucionet publike**, me Numër të prokurimit: **623-26-2269-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-012-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si **pjesërisht** e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **NNP CTA SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë në hapësira të jashtme dhe të brendshme në institucionet publike**, me Numër të prokurimit: **623-26-2269-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-012-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **17.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë në hapësira të jashtme dhe të brendshme në institucionet publike**, me Numër të prokurimit: **623-26-2269-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-012-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **NNP CTA SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rregullimi dhe mirëmbajtja e hidrosanitarisë në hapësira të jashtme dhe të brendshme në institucionet publike**, me Numër të prokurimit: **623-26-2269-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-012-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **17.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **18.04.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Në Njoftimit për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, afati i fundit për Sqarimin e Dosjes së Tenderit ka qenë deri me datë: 07.05.2026;

Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Pretendimi Nr. 1 – Menaxheri i Projektit

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me **Nenin 7 të LPP-së**, pasi kufizon konkurrencën dhe nuk siguron trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Kufizimi i përvojës vetëm në projekte hidrosanitare përjashton profesionistë të kualifikuar që kanë përvojë ekuivalente në menaxhim projektësh ndërtimore, infrastrukturore, ujësjellësi apo kanalizimi.

Kërkesa bie ndesh edhe me **Nenin 69 të LPP-së**, pasi aftësia teknike dhe profesionale duhet të kërkohet vetëm në masën që është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës. Në këtë rast, përvoja e kufizuar vetëm në hidrosanitare nuk është e domosdoshme për realizimin e kontratës.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me **Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024**, pasi kriteri është i ngushtë, kufizues dhe jo proporcional me objektin e kontratës. AK nuk ka arsyetuar pse nuk pranohet përvojë ekuivalente në menaxhim të projekteve të ngjashme.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

3.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Hidroteknike – me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, dëshmi që ka menaxhuar te paktën 2 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve inxhinierike dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

3.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Hidroteknike – me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, dëshmi që ka menaxhuar te paktën 2 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve inxhinierike dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujësjellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Pretendimi Nr. 2 – Inxhinier Konstruktiv

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me **Nenin 7 të LPP-së**, sepse kufizon konkurrencën duke pranuar vetëm përvojë në projekte hidrosanitare, edhe pse një inxhinier konstruktiv mund të ketë përvojë relevante në projekte ndërtimore ose infrastrukture.

Kërkesa është gjithashtu në kundërshtim me **Nenin 69 të LPP-së**, pasi aftësia teknike dhe profesionale duhet të lidhet me natyrën reale të kontratës dhe nuk duhet të vendoset në mënyrë të ngushtë e diskriminuese.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me **Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024**, sepse kriteri për përvojë vetëm në hidrosanitare nuk është proporcional dhe nuk lejon përvojë ekuivalente në fushën ndërtimore.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

3.2. Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, dëshmi që ka menaxhuar të paktën 2 vite përvojë pune në projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve inxhinierike dhe zbatim të projekteve të mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

3.2. Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, dëshmi që ka menaxhuar të paktën 2 vite përvojë pune në projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve inxhinierike dhe zbatim të projekteve të mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujësjellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Pretendimi Nr. 3 – Inxhinier Makinerik

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me **Nenin 7 të LPP-së**, pasi kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që kanë inxhinierë makinerikë me përvojë të ngjashme në sisteme mekanike, ujësjellës, kanalizim apo instalime teknike.

Kërkesa bie ndesh edhe me **Nenin 69 të LPP-së**, sepse aftësia teknike/profesionale nuk duhet të kërkohet në mënyrë më të ngushtë sesa është e nevojshme për realizimin e kontratës.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me **Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024**, pasi kriteri është kufizues dhe nuk pranon përvojë ekuivalente, edhe pse përvoja në sisteme mekanike ose instalime të ngjashme është e mjaftueshme për natyrën e kontratës.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

3.3. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, dëshmi qe ka menaxhuar te paktën 2 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve inxhinierike dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

3.3. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, dëshmi qe ka menaxhuar te paktën 2 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve inxhinierike dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujësjellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Pretendimi Nr. 4 – Mjeshtër i Drenazhimit

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 7 të LPP-së, pasi kufizimi i përvojës vetëm në hidrosanitare trajton në mënyrë të pabarabartë operatorët që kanë staf me përvojë të ngjashme në drenazhim, kanalizim, ujësjellës apo punime infrastrukturore.

Kërkesa është në kundërshtim edhe me Nenin 69 të LPP-së, sepse aftësia teknike duhet të dëshmohet në mënyrë proporcionale dhe jo përmes kufizimeve artificiale.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024, pasi kriteri nuk është proporcional me objektin e kontratës dhe nuk pranon përvojë ekuivalente në punë të ngjashme.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

4.1. Një (1) Mjeshtër të Drenazhimit, i njëjti duhet të i trajnuar për menaxhim dhe monitorimit të proceseve të drenazhimit, dëshmi qe ka menaxhuar te paktën 3 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

4.1. Një (1) Mjeshtër të Drenazhimit, i njëjti duhet të i trajnuar për menaxhim dhe monitorimit të proceseve të drenazhimit, dëshmi qe ka menaxhuar te paktën 3 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujësjellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Nr. 5 Ankimor:

Pretendimi Nr. 5 – Specialist Termoizolime

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me **Nenin 7 të LPP-së**, pasi vendosja e një pozite që nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës kufizon konkurrencën dhe krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë.

Kërkesa bie ndesh edhe me **Nenin 28 të LPP-së**, pasi kërkesat teknike duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe nuk duhet të vendosen pa nevojë reale.

Po ashtu, kërkesa bie ndesh me **Nenin 69 të LPP-së**, sepse nuk është dëshmuar se ky specialist është i domosdoshëm për aftësinë teknike/profesionale të operatorit për këtë kontratë.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me **Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024**, pasi pozita e specialistit të termoizolimeve nuk është arsyetuar si e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

4.2. Një (1) Specialist i trajnuar për punime të Termoizolimeve duhet të jetë i pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional, dëshmi që ka menaxhuar të paktën 3 vite përvojë pune në projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim të projekteve të mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

4.2. Një (1) Specialist i trajnuar për punime të Termoizolimeve duhet të jetë i pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional, dëshmi që ka menaxhuar të paktën 3 vite përvojë pune në projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim të projekteve të mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujësjellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Nr. 6 Ankimor:

Pretendimi Nr. 6 – Ekspert montimi tubave hidrosanitare

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me **Nenin 7 të LPP-së**, pasi kufizon konkurrencën duke mos pranuar përvojë ekuivalente në montim tubacionesh, ujësjellës, kanalizim apo rrjete teknike.

Kërkesa është në kundërshtim me **Nenin 69 të LPP-së**, pasi aftësia profesionale duhet të dëshmohet në bazë të përvojës relevante dhe jo vetëm përmes një fushe të emërtuar ngushtë nga AK.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë bie ndesh me **Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024**, pasi kriteri nuk është proporcional dhe nuk lejon përvojë ekuivalente që përmbush të njëjtin funksion teknik.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 6 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

4.3. Një (1) ekspert te certifikuar për vendosjen dhe montimin e tubave të sistemit hidrosanitarikë, dëshmi qe ka menaxhuar te paktën 3 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

4.3. Një (1) ekspert te certifikuar për vendosjen dhe montimin e tubave të sistemit hidrosanitarikë, dëshmi qe ka menaxhuar te paktën 3 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujësjellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Nr. 7 Ankimor:

Pretendimi Nr. 7 – Punëtor i Menaxhimit të Riskut

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 7 të LPP-së, pasi vendos një kriter artificial që kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pa u dëshmuar lidhja e drejtpërdrejtë me objektin e kontratës.

Kërkesa bie ndesh edhe me Nenin 69 të LPP-së, pasi aftësia teknike/profesionale duhet të kërkohet vetëm kur është e nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë rast, AK nuk ka dëshmuar se kjo pozitë është e domosdoshme.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë është në kundërshtim me Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024, pasi kriteri për këtë pozitë nuk është i arsyetuar, nuk është proporcional dhe krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 7 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

4.4. Një (1) Punëtor i Menaxhimit të Riskut min. 3 vite përvojë pas certifikimit, dëshmi qe ka menaxhuar pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

4.4. Një (1) Punëtor i Menaxhimit të Riskut min. 3 vite përvojë pas certifikimit, dëshmi qe ka menaxhuar pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujësjellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Nr. 8 Ankimor:

Pretendimi Nr. 8 – Teknik i Hidroteknikës

Shkelje e Ligjit për Prokurimin Publik:

Kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 7 të LPP-së, pasi kombinimi i përvojës së gjatë, trajnimeve shtesë dhe kufizimit vetëm në hidrosanitare krijon barrierë të panevojshme për konkurrencë.

Kërkesa bie ndesh edhe me Nenin 69 të LPP-së, sepse aftësia teknike dhe profesionale duhet të jetë proporcionale me objektin e kontratës dhe të lejojë përvojë ekuivalente.

Shkelje nga Rregullorja Nr. 002/2024:

Kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 25.18 të Rregullores Nr. 002/2024, pasi kriteri është i tepërt, kufizues dhe jo proporcional me natyrën e kontratës.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 8 Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i bazuara

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, do të bëjë korrigjimet sipas **Formularit për korrigjim të gabimeve B54:**

Në vend të:

4.5. Një (1) Teknik i Hidroteknikës, me përvojë pune min. 5 vite, I njëjti duhet të jete i trajnuar për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes duke përfshirë teknologjinë e kontrollit, dëshmi që ka menaxhuar të paktën 3 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve vetëm hidrosanitarisë;

Është (që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës):

4.5. Një (1) Teknik i Hidroteknikës, me përvojë pune min. 5 vite, I njëjti duhet të jete i trajnuar për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes duke përfshirë teknologjinë e kontrollit, dëshmi që ka menaxhuar të paktën 3 vite përvojë pune ne projekte nga lemia e kërkuar në menaxhimin e ekipeve profesionale dhe zbatim te projekteve te mirëmbajtjeve të drenazhimit, kanalizimit, ujës-jellës apo hidrosanitarisë;

Pretendimi Ankimor:

Pretendimi Nr. 9 – Lugë ngarkuese 360° / 3T

Pretendimi Nr. 10 – Eskavator robotik max 500 kg

Pretendimi Nr. 11 – Kositëse speciale me 8 kosa

Pretendimi Nr. 12 – Rimorkio bari 4m³

Pretendimi Nr. 13 – Traktor kositës me rezervar bari

Pretendimi Nr. 14 – Burg hidraulik për drunj

Pretendimi Nr. 15 – Kamion kiper me vinç 20m

Pretendimi Nr. 16 – Kompresor gjysmë-rimorkio

Pretendimi Nr. 17 – Automikser vetëngarkues

Pretendimi Nr. 18 – Dumper vetëshkarkues

Përgjigje në Pretendimet Ankimor:

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pa bazuara dhe nuk qëndron;

Asnjë nga pajisjet e pretenduara nga ana juaj, nuk janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, sipas tabelës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit;

Përcaktimi i këtyre kriterëve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu kërkesat e tillë janë të domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmimeve mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

AK: Komuna e Rahovecit, me rastin e vendosjes së kriterëve apo kërkesave kualifikuese ka kërkuar vetëm ato **kërkesat dhe dëshmitë që janë ngushtë të lidhura** me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit/ shiko Interpretimin Nr. 26 të dt. 09.06.2023.

Kërkesa janë absolutisht te domosdoshme për të konfirmuar nëse Operatori Ekonomik potencial, ka kapacitetin e nevojshme teknik dhe profesional për të realizuar këtë projekt me sukses, në mënyrë efikase dhe efektive.

Këto kërkesat/dëshmitë kanë qenë të monitoruara nga **KRPP Departamenti i Monitorimit**, ku neve si Autoritet Kontraktues nga ka dhënë **Rekomandimet** për kriteret diskriminuese apo kufizuese, ku ato rekomandimin i kemi pranuar si të bazuar dhe me **Formularit për korrigjim të** gabimeve janë larguar nga Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>